



Prishtinë, 01.12.2008

Nga: **Dr. Ali Hamiti**, Kryesues i Bordit të ZRrE-së

Për: **Z. Arben Gjuka**, UD. Drejtor Menaxhues, KEK Sh.A

Z. Fadil Ismaili, Drejtor Menaxhues, KOSTT Sh.A

Kopje: **Z. Blerim Rexha**, Zv. Ministër- Ministria e Energjisë dhe Minierave

Znj. Myzejne Selmani, Kryetare e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Z. Ethem Çeku, Zv. Kryetar i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Z. Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Energjisë-MEM

Z. Avni Alidemaj, UD. Drejtor i Divizionit të Rrjetit, KEK Sh.A

Z. Fahredin Maqastena, Drejtor i Divizionit të Furnizimit, KEK Sh.A

Z. Driton Rustemaj, Drejtor për Tarifa dhe Çështje Rregullative, KEK Sh.A

Z. Istref Klinaku, Drejtor Ekzekutiv i Gjenerimit, KEK Sh.A

Z. Adil Januzi, UD. Drejtor i Divizionit të Minierave

Znj. Resmije Ahma, Drejtoreshë për Çështje Ligjore dhe Rregullative, KOSTT Sh.A

Z. Salih Bytyqi, UD. Drejtor Financiar, KEK Sh.A

Z. Nebih Haziri, Drejtor Financiar, KOSTT Sh.A

Lënda: Shqyrtimi i Tarifave të Energjisë Elektrike 3 (ShTE3) – Parimet dhe Orari

Të nderuar,

Me këtë letër ftohen KEK Sh.A dhe KOSTT Sh.A t'i dorëzojnë për shqyrtim ZRrE-së aplikacionet për tarifave të energjisë elektrike që do të hyjnë në fuqi nga 1 prilli 2009. Ky do të jetë shqyrtimi i tretë i tarifave të energjisë elektrike (ShTE3).

Shqyrtimi i çmimeve nënkupton procesin e verifikimit të shpenzimeve të ndërmarrjeve energjetike, llogaritjes dhe përcaktimit të tarifave bazuar në mbulimin e shpenzimeve reale dhe të arsyeshme që i shkakton ndërmarrja energjetike, për ofrimin e shërbimeve për furnizim me energji elektrike. Gjithashtu vëmendje dhe kujdes i veçantë i kushtohet mbrojtjes së konsumatorëve gjithnjë duke marrë parasysh



Çmimin e Indeksit të Konsumit dhe Inflacionin, këto dy qasje paraqesin një balancim në mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe ndërmarrjeve energjetike.

Plani i zbatimit dhe orari i përcaktuar për shqyrtimin e tarifave për sektorin e energjisë elektrike paraqet një proces ku janë cekur obligimet dhe detyrat e ndërmarrjeve energjetike dhe të ZRRE-së. ZRRE-ja pret që aplikacionet e tarifave të cilat do të dorëzohen nga KEK Sh.A dhe KOSTT Sh.A të përfshijnë parashikimet e azhuruara të të hyrave të lejuara për të gjitha aktivitetet e rregulluara për vitin 2009, duke përfshirë edhe të hyrat të cilat duhet të mbulohen nga tarifat me pakicë të rregulluara që ju ngarkohen konsumatorëve jo të privilegjuar, ngarkesat e rregulluara të transmisionit dhe ngarkesat e shfrytëzimit të sistemit të distribucionit. (SHST dhe respektivisht SHSSH).

Parimet e Aplikimit

Aplikacionet për shqyrtimin e tarifave duhet të jenë në përputhje me parimet e aplikuara gjatë ShTE1 dhe SHTE2. Për të ndihmuar në këtë, ZRRE-ja para se të fillojë SHTE2 kishte përgatitur dy shënime udhëzuese që përmbledhin qasjet për t'i vendosur të hyrat e lejuara dhe tarifat e rregulluara. Po ashtu ZRRE ka përgatitur edhe Udhëzuesin mbi modelin e të hyrave dhe tarifave (RTM), për t'u ndihmuar përdoruesve që ta kuptojnë më mirë Modelin e të Hyrave dhe Tarifave.

ZRRE propozon që parimet në vijim duhet të zbatohen tek aplikacionet e tarifave të dorëzuara sipas ShTE1 dhe SHTE2:

- Struktura ekzistuese e tarifave dhe kategoritë e konsumatorëve duhet të mbeten të pandryshuara. Ndryshimet tjera do të reduktojnë stabilitetin dhe parashikueshmërinë e tarifave tek konsumatorët si dhe do të detyrojnë KEK SH.A të pësojë kosto të reja thelbësore në shqyrtimin e sistemit të faturimit.
- Duhet të ketë një lëvizje graduale në tarifat që reflektojnë kostot. Tarifat e shqyrtuara duhet të vazhdojnë të lëvizin në drejtim të tarifave që pasqyrojnë kostot (kosto reflektive), duke përfshirë edhe ribalancimin e tarifave relative industriale, komerciale dhe shtëpiake, gjersa në të njëjtën kohë janë marrë parasysh edhe çështjet e përbalueshmërisë së pagesës.
- Ngarkesat e ndara të shfrytëzimit të sistemit shpërndarës (SHSSH) duhet të identifikohen. Edhe pse ngarkesat SHSSH janë llogaritur sipas ShTE1 dhe SHTE2, këto nuk ishin miratuar apo bërë të plotfuqishme. Me zgjatjen e pritjes të pragut të privilegjuar sipër të cilit konsumatorët mund të zgjedhin furnizuesin e tyre për të përfshirë konsumatorët të lidhur me rrjetin shpërndarës, do të jetë e nevojshme të vendosen ngarkesa të caktuara të SHSSH. ZRRE, inkurajon KEK-un që në shqyrtimet vijuese të çmimeve grupi i konsumatorëve shtëpiake 0.4 kV pa matës të pajisen me njehsorë në mënyrë që të eliminohet ky grup i përkohshëm tarifor.

Orari tregues

ZRRE-ja pret që t'i pranojë aplikacionet për shqyrtimin e tarifave në kohën e paraparë që të mund të hyjnë në fuqi nga data 1 prill 2009.

Duke marrë parasysh afatet e caktuara në *Rregullën e Parimeve të Kalkulimit të Tarifave për Sektorin e Energjisë*, ('Rregulla e Çmimeve'), kemi orarin si në vijim për ShTE3:

- 10 dhjetor 2008 – dërgimi i shablloneve për aplikim nga ZRRE tek KEK SH.A. dhe KOSTT SH.A.
- Deri më 22 dhjetor 2008 – dorëzimi i aplikacioneve preleminare për tarifa nga KEK SH.A. dhe KOSTT- SHA.



- 16 janar 2009 - shqyrtimi dhe analizimi i aplikacioneve për tarifa, si dhe i të dhënave dhe informatave, më pastaj nxjerrja dhe dërgimi i komenteve nga ZRRE tek KEK SHA dhe KOSTT-SHA.
- 26 janar 2009 – përgjigjet e pranuar nga KEK SHA dhe KOSTT SHA.
- 16 shkurt 2009 – dorëzimi i aplikacioneve finale për tarifa nga KEK SHA dhe KOSTT ShA.
- 3 mars 2009 – shqyrtimi i aplikacioneve të tarifave nga ZRrE-ja, duke përfshirë konsultimin e palëve të interesuara.
- 15 mars 2009 - komentet e marra nga palët e interesuara lidhur me Raportin Konsultativ të SHTE3.
- 31 mars 2009 – vendimi i tarifave të aprovuara nga ZRrE-ja.
- 1 prill 2009 – data e hyrjes në fuqi të tarifave të reja.

ZRrE-ja mirëpret çfarëdo komenti që mund të keni lidhur me parimet dhe orarin e paraqitur në këtë letër. Ju lutem dërgoni komentet tuaja deri më 8 dhjetor 2008. Komunikimet lidhur me këtë letër duhet të adresohen në ERO.PRICING-TARIFFS@ero-ks.org

Në përputhje me parimin e ZRrE-së për transparencë në punë, kjo letër dhe çfarëdo përgjigje do të publikohen në faqen elektronike të ZRrE-së.

Presim përgjigjen tuaj.

Me respekt,

Dr Ali Hamiti
Kryesues i Bordit të ZRrE-së